



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:233580

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05761229

C.nr.417/2018

PROCESVERBAL I SEANCËS PËRGATITORE

I përpiluar më datë 31.05.2024, në GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil në çështjen juridike të paditëses KEP Trust të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.D kundër të paditurve Rr.H dhe S.H, me objekt kontesti pagim i borxhit nga marrëveshja mbi kredinë.

P r e z e n t:

Gjyqtari:
Leotrim Gashi

Për paditësen
L.D sipas autorizimit

Zyrtare ligjore
Liridona Bajrami

Të paditurit:
Rr.H
S.H

Pyeten palët se a kanë vërejtje në përbërjen e gjykatës:

Pa vërejtje nga palët.

Seanca është publike

Filloj ne ora 09:30

Gjyqtari i çështjes e hap shqyrtimin mbi këtë çështje, e publikon lëndën e shqyrtimit dhe konstaton se në këtë seancë prezent është përfaqësuesi i autorizuar i paditëses L.D si dhe të paditurit Rr.H dhe S.H.

Andaj gjykata konstaton se ka kushte ligjore për mbajtjen e seancës, e si rrjedhojë merr:

A K T V E N D I M

Seanca e sotme mbahet dhe e njëjta është publike.

Gjykata i njofton palët prezente se duhet të mbajnë rendin dhe qetësinë në gjykatë dhe nuk duhet të flasin derisa gjykata të iu jap fjalën, për prishje të rendit dhe qetësisë në seancë gjyqësore, gjykata mund që duke u bazuar në nenin 289.2 të LPK-së, fillimisht do t'i qortojë palët dhe nëse kjo rezulton të jetë e pasuksesshme mundet që ti largoj nga salla dhe t'iu shqiptojë gjobë deri në 500 euro.

Gjykata i njofton palët së në këtë seancë përgatitore duhet të parashirojnë të gjitha faktet në të cilat mbështesin kërkesat e tyre si dhe të propozojnë të gjitha provat më të cilat pretendojnë të vërtetojnë faktet e tilla.

Gjykata i njofton palët se kontestin mund ta zgjidhin edhe në procedurën e ndërmjetësimit, në pajtim me nenin 411 të LPK – së si dhe me anë të pajtimit gjyqësor siç parashihet në nenin 412 të LPK – së.

Lidhur me mundësinë e zgjidhjes së këtij kontesti përmes procedurës së ndërmjetësimit apo pajtimit gjyqësor përfaqësuesi i paditëses, deklaron:

Pasi që kemi një marrëveshje verbale me palët e paditura, dhe të njëjtit kanë filluar ta paguajnë gradualisht borxhin propozojmë që të arrijmë pajtim gjyqësor në gjykatë.

Lidhur me mundësinë e zgjidhjes së këtij kontesti përmes procedurës së ndërmjetësimit apo pajtimit gjyqësor i padituri Rr.H, deklaron:

Pajtohem me propozimin e përfaqësuesit të paditëses që të arrijmë pajtim gjyqësor.

Lidhur me mundësinë e zgjidhjes së këtij kontesti përmes procedurës së ndërmjetësimit apo pajtimit gjyqësor paditura S.H, deklaron:

Pajtohem me propozimin e përfaqësuesit të paditëses që të arrijmë pajtim gjyqësor.

Ftohet përfaqësuesi e paditëses, që të deklarohej dhe i njëjti deklaron:

Mbes në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë të paraqitur pranë kësaj gjykate, ndaj të paditurve Rr.H dhe S.H e datës 14.09.2018, për pagimin e borxhit nga marrëveshja mbi kredinë, në vlerë prej 1,600.55 euro.

Me të paditurit në fjalë kam arritur një marrëveshje verbale të cilët kanë respektuar marrëveshjen dhe kanë paguar me rregull nga 50 euro në muaj, në disa muaj nga 35 euro, ku borxhi nga pagesa të cilët janë duke e bërë të paditurit pas marrëveshjes ka ndryshuar dhe borxhi aktual me të cilin obligohen të paditurit është 1,303.42 euro.

Me këtë marrëveshje kërkoj edhe shpenzimet për taksë gjyqësore në shumë prej 30 euro, andaj siç u dakorduam edhe me të paditurit propozoj që nga vlera e precizuar të përshihet edhe taksa gjyqësore, borxhi të paguhet me këste mujore nga 50 euro në muaj, deri në përfundimin definitiv të këtij borxhi. Datat e pagesës janë nga data 01 deri më datë 05 të çdo muaji vijues dhe atë duke filluar nga muaji Qershor 2024.

Ftohet i padituri Rr.H, që të deklarohej dhe i njëjti deklaron:

Pajtohem me propozimin e përfaqësuesit të paditëses që të arrijmë pajtimin gjyqësor e lartpropozuar

Ftohet e paditura S.H, që të deklarohej dhe i njëjti deklaron:

Pajtohem me propozimin e përfaqësuesit të paditëses që të arrijmë këtë pajtimin gjyqësor e lartpropozuar.

Palët deklarojnë se në mes vete kanë arritur marrëveshje dhe i propozojnë gjykatës për aprovim këtë:

PAJTIM GJYQËSOR

- I. DETYROHEN të paditurit Rr.H dhe S.H, që në mënyrë solidare, në emër të kthimit të borxhit për pagesën e kredisë, të arritur në marrëveshjen e kredisë numër KOMI-008715-003 të datës 21.07.2017,

të ia paguajë paditësit KEP Trust, shumën prej 1,303.42 euro, me këste, ku shuma e këstit do të jetë 50 euro për çdo muaj, me ç' rast pagesa do të bëhet nga data 01 -05 të çdo muaji vijues dhe atë duke filluar nga muaji Qershor 2024, deri në pagesën e plotë.

- II. Pagesa do të bëhet në secilën prej pikave të bankës KEP Trust në Republikën e Kosovës.
- III. DETYROHEN të paditurit që në emër të shpenzimeve të procedurës të paguajnë paditësit, taksën gjyqësore në vlerë prej 30 euro.

Pasi që gjykata konstatoi se në këtë rast disponimet e palëve nuk bien në kundërshtim me nenin 3 par.3.3 të LPK-së, gjykata bazuar në nenin 414 par.1 të LPK-së, bie këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET në tërësi pajtimi gjyqësor i lartëproponuar i palëve ndërgjyqëse.

II. Ky pajtim gjyqësor ka titull ekzekutiv dhe i njëjti mund të goditet vetëm me padi.

Procesverbali pasi u dëgjua me zë i njëjti edhe u nënshkrua pa vërejtje.

Përfundoi në ora 09:50 minuta.

Përfaqësuesi i paditëses

Të paditurit:

1. _____

2. _____

V ë r t e t o j n ë

Zyrtarja ligjore

Gj y q t a r i
